



Financuar nga
Bashkimi Evropian



PLATFORMA



RRJETI ANTIKORRUPSION.AL

PARTNERITET PËR TRANSPARENCË
DHE MIRËQEVERISJE



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



A.L.T.R.I




1 | RRJETI ANTIKORRUPSION.AL

Rrjeti Antikorrupsion është një platformë kombëtare e ngritur për të mbështetur shoqërinë civile, institucionet publike, median dhe biznesin në luftën kundër korrupsionit. Ajo ofron një hapësirë gjithëpërfshirëse për monitorim, raportim dhe analizë të fenomeneve korruptive, duke shërbyer si një kanal bashkëpunimi dhe një mjet konkret për të kërkuar transparencë dhe llogaridhënie.

Roli i platformës është shumëplanësh:

- **Angazhimi i aktorëve të ndryshëm** – duke përfshirë shoqërinë civile, institucionet publike, median dhe biznesin në një dialog të vazhdueshëm mbi masat antikorrupsion.
- **Koordinimi i përpjekjeve dhe nxitja e iniciativave të përbashkëta**, që sjellin më afër aktorë të ndryshëm për të zhvilluar projekte dhe veprime konkrete kundër korrupsionit.
- **Monitorimi dhe diskutimi mbi masat kundër korrupsionit**, duke ndjekur nga afër politikën, ligjet dhe reformat, si dhe duke nxitur debate mbi efektivitetin e tyre.
- **Informimi dhe ndarja e produkteve analitike**, përmes publikimeve, raporteve dhe analizave që pasqyrojnë situatën e korrupsionit në vend dhe japin rekomandime për përmirësime.



Platforma është menduar si një pikë referimi për informacion të besueshëm dhe për shkëmbimin e përvojave. Përmes saj, çdo anëtar apo aktor i përfshirë ka mundësi të kontribuojë me ide dhe propozime, duke u bërë pjesë e një komuniteti aktiv që punon për të forcuar integritetin dhe qeverisjen e mirë.

Qëllimi madhor i Rrjetit është fuqizimi i shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë për të rritur pjesëmarrjen, monitorimin, advokimin dhe kapacitetet e administratës publike, duke kontribuar në një proces politikëbërës më gjithëpërfshirës dhe në funksion të integritimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.



2 | MISIONI

Misioni ynë është të forcojmë transparencën, integritetin dhe qeverisjen e mirë, duke ndërtuar ura bashkëpunimi mes qytetarëve, shoqërisë civile, institucioneve publike, bizneseve dhe medias.



3 | ANËTARËT DHE AKTORËT E PËRFSHIRË NË RRJETIN KOMBËTAR KUNDËR KORRUPSIONIT

Platforma rrjetiantikorrupsion.al është krijuar si një mekanizëm komunikimi dhe ndërveprimi për Rrjetin Kombëtar të Organizatave të Shoqërisë Civile Kundër Korrupsionit. Fillimisht e konceptuar si një mjet për të ndarë nisma, për të promovuar projektet e ndërmarra dhe për të lehtësuar shkëmbimin e përvojave dhe ideve mes organizatave anëtare, platforma ka marrë gradualisht një rol më gjithëpërfshirës, duke u shndërruar në një hapësirë dialogu dhe bashkëpunimi për aktorë të ndryshëm të shoqërisë.

Rrjeti Kombëtar i Organizatave të Shoqërisë Civile Kundër Korrupsionit lindi si një nismë e projektit “Shoqëria civile kundër korrupsionit, nga një sfidë vendase në një përgjigje Evropiane”, financuar nga Bashkimi Evropian. Ai përfaqëson një koalicion unik, të ndërtuar mbi angazhimin vullnetar dhe bindjen se vetëm përmes veprimit të përbashkët mund të arrihen rezultate të prekshme në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies publike.

Aktualisht, rrjeti përbëhet nga 53 organizata të shoqërisë civile, të shtrira në të gjithë territorin e Shqipërisë, të cilat operojnë në fusha të ndryshme si drejtësia, të drejtat e njeriut, qeverisja e mirë, të rinjtë, barazia gjinore, edukimi dhe mbrojtja e interesit publik.

Këto organizata kanë bashkuar kapacitetet e tyre dhe janë angazhuar në mënyrë vullnetare për të ndërtuar një kulturë integriteti dhe për të reduktuar hapësirat e korrupsionit.

Vizioni i platformës shkon përtej shoqërisë civile, duke synuar të përfshijë edhe:

- **Institucionet publike**, në nivel qendror dhe lokal, si pjesë aktive e përpjekjeve kundër korrupsionit;
- **Përfaqësuesit e biznesit**, të cilët kontribuojnë në krijimin e një tregu të ndershëm dhe konkurrues;
- **Mediat dhe gazetarët**, që luajnë një rol kyç në informimin e publikut, investigimin e rasteve dhe nxitjen e transparencës;
- **Qytetarët**, të cilët përmes raportimeve, ideve dhe pjesëmarrjes aktive bëhen pjesë e drejtpërdrejtë e monitorimit të korrupsionit.

Kjo qasje gjithëpërfshirëse e kthen rrjetin jo vetëm në një mekanizëm bashkëpunimi të shoqërisë civile, por edhe në një platformë kombëtare të dialogut dhe veprimit të përbashkët, ku çdo aktor sjell ekspertizën, përgjegjësinë dhe vizionin e vet për një shoqëri më të drejtë dhe transparente.

ANËTARËT E RRJETIT KOMBËTAR TË OSHC-VE KUNDËR KORRUPSIONIT

1. **Agjencia Rajonale e Zhvillimit Berat**
2. **Akademia e Integritit European dhe Negociatave (AIEN)**
3. **ALTRI Center**
4. **Center for Bridging Communities (CBC)**
5. **Change and Development Center**
6. **European Movement Albania (EMA)**
7. **Fondacioni “Agjencia Rajonale e Zhvillimit Vlorë” (ARZHV)**
8. **Fondacioni Drejtesi dhe Paqe**
9. **Fondacioni Prek Cali New York Inc**
10. **Fuqizim dhe Organizim Komunitar**
11. **Horizont EU**
12. **Horizont i Hapur**
13. **Intelektualet e rinj, Shprese (IRSH)**
14. **Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri (IRCA)**
15. **Instituti i Studimeve Politike (ISP)**
16. **Joscelyn Foundation (JsF)**
17. **Komiteti Shqiptar i Helsinkit**
18. **Kryqi i Kuq Shqiptar – Dega Berat**
19. **Nisma ARSIS**
20. **Qendra “Act Think Centre”**
21. **Qendra “Be the Change”**
22. **Qendra “Durrësi Aktiv”**
23. **Qendra “Platforma Kombëtare për Gratë” (PKG)**
24. **Qendra A.I.A (Albanian Innovation Accelerator)**
25. **Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim (GADC)**

- 26. Qendra e Gruas Hapat e Lehtë**
- 27. Qendra e Këshillimit dhe Shërbimeve Psikologjike**
- 28. Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara (QSHPLI)**
- 29. Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile (CSDC) – Durrës**
- 30. Qendra Europiane**
- 31. Qendra Konsumatori Shqiptar Durrës**
- 32. Qendra Konsumatori Shqiptar Elbasan**
- 33. Qendra për Drejtësi Gjimore në Shqipëri (QDGJSH)**
- 34. Qendra për Fuqizimin Ligjor (CLE)**
- 35. Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL)**
- 36. Qendra për Zhvillim dhe Integrim Evropian (CEDI)**
- 37. Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen”**
- 38. Qendra Psiko-Sociale “Vatra”**
- 39. Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (ACER)**
- 40. Resurset në Zhvillim**
- 41. Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN)**
- 42. Rrjeti i Informimit dhe Qytetarisë Aktive (INAC)**
- 43. SAS - Special Achievement Services**
- 44. Save the Children Albania**
- 45. Sërish Horizont**
- 46. Shoqata “Gruaja Verilindore e pa pune”**
- 47. Shoqata Mjedisore SIRA**
- 48. Shoqata për Kulturë Demokratike (SHKD)**
- 49. Shoqata Tjeter Vizion**
- 50. Shoqata Together for Life (TFL)**
- 51. Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS)**
- 52. Social Contract Institute (SCI)**
- 53. United Nations Association Albania**


4 | ÇFARË OFRON PLATFORMA?

Platforma rrjetiantikorruption.al është konceptuar si një hapësirë gjithëpërfshirëse që lehtëson ndërveprimin, shkëmbimin e informacionit dhe pjesëmarrjen aktive të qytetarëve, shoqërisë civile, institucioneve publike, mediave dhe biznesit. Përmbajtja e saj strukturohet në disa seksione kryesore, secili me funksion të veçantë:

a) Publikime dhe materiale; Ky seksion përmban një koleksion të pasur artikujsh, raporte kërkimore, studime të rasteve, manuale dhe materiale edukative mbi korrupsionin dhe qeverisjen e mirë. Të gjitha këto publikime janë të aksesueshme për publikun dhe synojnë të rrisin ndërgjegjësimin qytetar, të ofrojnë njohuri praktike dhe të fuqizojnë aktorët e ndryshëm për të kuptuar dhe monitoruar fenomenet korruptive. Përdoruesit mund të gjejnë informacione të detajuara mbi sektorë të ndryshëm të administratës publike dhe praktikave të integritetit, duke i mundësuar ata të ndërmarrin veprime konkrete në komunitetet e tyre.



b) Forum diskutimi; Platforma ofron një hapësirë interaktive ku anëtarët e saj të mund të ndajnë mendime, ide dhe përvoja mbi temat që lidhen me korrupsionin, transparencën dhe qeverisjen e mirë. Ky forum promovon dialogun konstruktiv, lejon shkëmbimin e përvojave praktike dhe nxit krijimin e zgjidhjeve inovative për sfidat e përbashkëta.



c) Raportime dhe denoncime; Platforma ofron një mundësi të veçantë për qytetarët që të lidhen drejtpërdrejt me kanalet publike ku mund të denoncohen rastet e korrupsionit në administratën publike. Përmes saj, individët mund të raportojnë praktika ose raste të dyshuara korrupsioni, duke kontribuar në evidentimin e problematikave dhe duke nxitur veprime nga institucionet përkatëse. Ky seksion fuqizon qytetarët, duke i kthyer ata në pjesëmarrës aktiv në procesin e monitorimit të transparencës dhe llogaridhënies.


d) Sondazhe dhe anketime; Platforma zhvillon sondazhe dhe anketime për të matur perceptimin e qytetarëve mbi korrupsionin dhe efektivitetin e masave të ndërmarra. Të dhënat e mbledhura ofrojnë një pasqyrë të vlefshme për analizat, ndihmojnë në zhvillimin e politikave publike dhe forcojnë bazën e vendimmarrjes mbi transparencën dhe integritetin.



5 | BOTIMET TONA

Platforma rrjetiantikorruption.al publikon materiale të ndryshme të përgatitura nga anëtarët e saj, të cilat adresojnë tematika të lidhura me luftën kundër korrupsionit, qeverisjen e mirë dhe çështjet e drejtësisë. Këto përfshijnë artikuj, raporte, studime, manuale dhe materiale edukative, duke ofruar njohuri, analiza dhe perspektiva të ndryshme mbi sfidat dhe nevojat për përmirësim në këto fusha.

Qëllimi i këtyre botimeve është të krijojë një bibliotekë online të aksesueshme për përdoruesit e platformës, e cila shërben jo vetëm për informim, por edhe si mjet për të advokuar për ndryshime dhe përmirësime. Përmes këtyre botimeve, përdoruesit mund të aksesojnë materiale të strukturuar dhe të përdorshme për edukim, debat dhe veprim konkret, duke kontribuar në një qeverisje më të mirë dhe një shoqëri më të drejtë dhe transparente.



6 | PSE TË PËRFSHIHENI?

Përfshirja në platformë ofron një gamë të gjerë përfitimesh dhe mundësish:



Mundësi koordinimi dhe bashkëpunimi në kohë reale me aktorë të ndryshëm, si OSHC, institucione publike, biznese, media etj.



Nismë e përbashkët për adresimin e çështjeve prioritare, duke u kthyer në një zë të fuqishëm dhe të koordinuar.



Akses në një bibliotekë të pasur informacioni, analiza dhe studimesh mbi korrupsionin, qeverisjen e mirë dhe çështjet e drejtësisë, të cilat mund të përdoren për analiza, raporte apo studime të mëtejshme.



Mundësi për t'u përfshirë në proceset e vendimmarrjes dhe politikbërjes, duke kontribuar drejtpërdrejt në përmirësimin e praktikave dhe politikave.



7 | SFIDA DHE PLANET PËR TË ARDHMEN

Lufta kundër korrupsionit mbetet një sfidë komplekse dhe e vazhdueshme. Platforma synon që në vitet e ardhshme të forcojë rolin e saj si një mjet i besueshëm për qeverisje të mirë, transparencë dhe advokim të politikave. Ndër synimet kryesore janë:

- Zgjerimi i ndikimit në nivel lokal, duke përfshirë më shumë komunitete dhe aktorë të ndryshëm.
- Forcimi i bashkëpunimit me institucionet publike, mediat dhe aktorë të tjerë kyç për të rritur efektivitetin e iniciativave kundër korrupsionit.
- Pasurimi i platformës me më shumë burime informative, studime, raporte dhe materiale praktike që mund të përdoren për analiza dhe veprim konkret.
- Promovimi i transparencës përmes fushatave të reja ndërgjegjësimi, trajnimeve dhe aktiviteteve që nxisin pjesëmarrjen aktive dhe ndikimin në vendimmarrje.



8 | SI TË NA KONTAKTONI



*Bëhuni pjesë: regjistrohuni,
kontribuoni dhe ndani
përvojën tuaj.*



RRJETIANTIKORRUPSION.AL



Financuar nga
Bashkimi Evropian



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



A.L.T.R.I



Ky dokument u realizua në kuadër të projektit “Shoqëria civile kundër korrupsionit, nga një sfidë vendase në një përgjigje Evropiane!”, financuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e këtij materiali është përgjegjësi e vetme e Qendrës ALTRI dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e Bashkimit Evropian.